Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSAMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINA SKENDERAJ
Nr. No. 01-400/01-0041379/26
Data Data 02-10-2026

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/ Skupstina Opstine/Municipal Assambly

Në bazë të nenit 11, 12 par. 1 dhe 2, shkronja d), neni 40 par. 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 2 dhe 4 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, bazuar në kërkesën Nr. 02-217/01-0036755/26 e datës; 26.08.2026, neni 14 par. 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt nr. 01-110-385, i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 29.09.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

(Për mbështetje me mjete financiare për Osman Bytyqi, nga Fshati Abri e Poshtme, Komuna Skenderaj)

Neni 1

Miratohet propozim-vendimi me Nr.02-400/01-0038536/26, i datës; 07.09.2026, Mbi lejimin e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve nga Drejtoria e Shërbimeve Publike .

Neni 2

Miratohet vendim mbi lejimin e mjeteve financiare në shumë prej **10,000.00€**, (dhjetë mijë euro), nga kategoria e subvencioneve nga Drejtoria për Shërbime Publike, për **z. Osman Bytyqi**, nga fshati Abri e Poshtme, Komuna e Skenderajt.

Neni 3

Mjetet e parapara nga neni 2 i këtij vendimi ndahen për rindërtimin e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të djegura si pasojë e zjarrit.

Neni 4

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nen mbikëqyrje të Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit te tij ne ueb – faqen të Komunës.

Vendimi i Dërgohet :
1x1 Arkivit,
1x1 Zyrës Kryetarit,
1x1 MAPL-së,
1x1 DSHP-së
1x1 DBF-së,
1x1 Dosjes.

KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu-Alija

REPUBLIKA E KOSOVËS · KUVENDI KOMUNAL · SKUPŠTINA OPŠTINE · REPUBLIKA KOSOVA · MUNICIPALITY · SKENDERAJ

Neni 17
Shpenzimi i parave publike

17.1 Paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike. Asnjë autoritet publik, organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojnë, keq zbatojnë, ekspozojnë apo të përdorin në mënyrë të pa rregullt paratë publike.

17.2 Shpenzimi i parave publike mund të bëhet vetëm nga fondet e ndara dhe të alokuara dhe vetëm në përputhje me procesin i cili është themeluar nga aktet nënligjore , sipas paragrafit 2 të nenit 38 të këtij ligji.

5. Bazuar në ndarjet buxhetore të përcaktuara në Tabelën 4.1, pjesë përbërëse e Ligjit për Buxhetin 2026, Departamenti i Buxhetit ka konstatuar se Komuna e Skenderajt ka të planifikuara ndarjet buxhetore përkatëse dhe disponon mjete të lira në SIMFK për vitin 2026, të mjaftueshme për zbatimin financiar të këtij vendimi. Mjetet për zbatimin e vendimit janë të planifikuara në nën-programin "Infrastruktura Rrugore", me kod 18023, në kuadër të programit "Shërbimet publike, mbrojtja civile emergjente", në kategorinë ekonomike "Subvencione dhe transfere".

6. Rrjedhimisht, Ministria konstaton se, nga aspekti i mbulimit dhe disponueshmërisë së mjeteve buxhetore, ekzistojnë ndarjet buxhetore dhe mjetet e lira në SIMFK për realizimin e mbështetjes financiare të përcaktuar me këtë vendim, në përputhje me nenin 17, paragrafi 2, të LMFPP-së.

7. Si përfundim, dhe duke marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria e Financave vlerëson se **akti administrativ i Komunës së Skenderajt është në përputhje me legjislacionin në fuqi**, dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Skenderajt dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave